



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Duke u bazuar në dispozitat e nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 18 të Ligjit për bashkëpunim ndërkomunal Nr.04/L-010 , Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.7 e datës 10 gusht 2011, neneve 5, 6 dhe 7 të Rregullores për procedurën e bashkëpunimit komunal ndërkombëtar Nr.0203 - 1334 e datës 18.12.2012, si dhe nenit 20 par.20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të datës 26.09.2008 , Kuvendi i Komunës në mbledhjen e datës 29.03.2018 miratojë këtë

VENDIM

PËR MIRATIMIN E NISMËS SË BASHKISË SË FRASCINETO NGA ITALIA PËR BINJAKËZIM NDËRMJET KOMUNAVE TË ITALISË CIVITA DHE FRASCINETO ME KOMUNAT E REPUBLIKËS SË KOSOVËS LIPJAN DHE FUSHË KOSOVË

Neni 1

Miratohet Nisma e Bashkisë së Frascineto nga Italia për binjakëzim ndërmjet komunave të Italisë Civita dhe Frascineto me komunat e Kosovës Lipjan dhe Fushë Kosovë.

Neni 2

Binjakëzimi do të karakterizohet me:

- a. Favorizimin e ndjenjës së miqësisë e bashkëpunimit ndërmjet komuniteteve përkatëse;
- b. Promovimin e iniciativave të shkëmbimit e bashkëpunimit në çdo aspekt të jetës sociale dhe kulturore të komunave;
- c. Mbështetjen e shkëmbimit të përvojave, dhe përmes organizimit të festave, manifestimeve, aktiviteteve kulturore dhe rekreative;
- d. Organizimin e shkëmbimeve mes institucioneve shkollore të shoqatave të komuniteteve përkatëse ;
- e. Favorizimin e shkëmbimeve të natyrës turistike –kulturore dhe ekonomike – profesionale;
- f. Favorizimin e shkëmbimeve mes Shoqatave kulturore dhe vullnetare për realizimin e takimeve muzikore, shfaqjeve teatrale, ekspozitave të artit, konferencave dhe takimeve me qëllim që të favorizohet ngritja e vetëdijes dhe e kontrastit kulturor që karakterizon realitetet e ndryshme sociale dhe të promovohet procesi i integritimit evropian;
- g. Favorizimin e shkëmbimeve ndërmjet shoqatave sportive për organizimin e garave në disiplina të ndryshme, iniciativat që përfaqësojnë një faktor të bashkimit dhe të paqes mes të rinjëve.

Neni 3

Detajet e bashkëpunimit do të përcaktohen me Marrëveshjen për vendosjen e bashkëpunimit komunal ndërkombëtar e cila do të hartohet në koordinim dhe konsultim me Komunitetet e cekura në nenin 1 të këtij Vendimi.

Neni 4

Draft - Marrëveshja për vendosjen e bashkëpunimit komunal ndërkombëtar do të dërgohet Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal për të vlerësuar ligjshmërinë sipas procedurës së paraparë me nenin 6 par.6 të Rregullores për procedurën e bashkëpunimit komunal ndërkombëtar.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi 7 pas publikimit në faqen elektronike të Komunës .

15Nr. *016-20215/18*
Lipjan, më 30.03. 2018

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

KRYESUESI I KUVENDIT
Daut Azemi

